



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.727/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Premija International D.O.O. SH.P.K, me seli në Novi Pazar-Serbi, të cilin e përfaqëson me autorizim A.D. avokat në Prishtinë, kundër debitorit Railtrans L.L.C., SH.P.K., me seli në Prishtinë, Zona Industriale Fushë Kosovë, ish Fabrika e Amortizatorëve, kati 3, nr.52, të cilin e përfaqëson me autorizim N.S. avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.330/2022 të datës 28.03.2023, me datë 30.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e debitorit Railtrans L.L.C. shpk me seli në Prishtinë, Zona Industriale Fushë Kosovë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.330/2022 i datës 28.03.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.330/2022 të datës 28.03.2023, në pikën I të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar propësimin e debitorit Railtrans L.L.C, shpk, të paraqitur kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020 të nxjerrë nga përmbaruesi privat Eset Murati. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020 të lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i debitorit për shkak të cënimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet propozimi i kreditorit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditorit duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e debitorit, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pathemeltë, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Premija International D.O.O. shpk me seli në Novi Pazar-Serbi, përmes të autorizuarit të tij më datë 03.12.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Railtrans L.L.C., SH.P.K., me seli në Prishtinë, Zona Industriale Fushë Kosovë, ish Fabrika e Amortizatorëve, kati 3, nr.52, në bazë të dokumentit besueshëm – faturës nr.125 të datës 31.01.2020 dhe faturës nr.127 të datës 31.01.2020, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 2.500,00 €.

Përmbartuesi privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se urdhri përmbartimor i lëshuar në bazë të faturave kontestuese nuk është i bazuar dhe nuk mbështet në prova, i njëjti është i palejueshëm pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore në bazë të dispozitave të nenit 22, 29, 37 dhe 38 të LPP-së, për caktimin e urdhrit përmbartimor në bazë të faturave, për faktin se faturat e bashkangjitura propozimit për përmbartim nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuar nga origjinal dhe se të njëjtat nuk janë pranuar nga debitori ashtu siç parashihet me ligj dhe se kamatëvonesa prej 14.43 % e kërkuar nga kreditori është në kundërshtim me dispozitën e nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se faturat e bashkangjitura propozimit për përmbartim janë në origjinal, të njëjtat janë të mbështetura edhe me CMR të dorëzuar në origjinal bashkangjitur secilës faturë. Tutje ka arsyetuar se debitori i ka pranuar faturat në bazë të cilave është lejuar përmbartimi e kjo vërtetohet më së miri me nënshkrimin e CMR-ve bashkangjitur secilës faturë si dhe të njëjta fatura janë pranuar nga i autorizuari i debitorit përmes postes elektronike me datë 09.11.2020, ndërsa sa i përket kamatës ka arsyetuar se e njëjta është konform ligjit, andaj ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës me aktvendimin KPPP.nr.330/2022 të datës 28.03.2023, në pikën I të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Railtrans” L.L.C., SH.P.K., të paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020 të nxjerrë nga përmbaruesi privat Eset Murati. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020 të lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar dhoma e shkallës së parë, ka arsyetuar se pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është tërësisht i pabazuar, për arsye se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, të njëjtat janë paraqitur në origjinal dhe janë pranuar përmes shërbimit postar nga debitori me datë 16.11.2020. Sa i përket kamatës së aplikuar gjykata ka arsyetuar se e njëjta është konform ligjit special – Ligjit 05/L-110 Për kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare neni 4, për arsyes se në këtë çështje përmbarimore kemi të bëjmë me transaksione të realizuara në mes dy shoqërive tregtare.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 11 të LPP-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 3 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke lënë në fuqi urdhrin për përmbarim P.nr.1675/2020 të datës 03.12.2020. Dhoma e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk e ka marrë parasysh dhe njëherit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm – faturat, faturën nr.125 të datës 31.01.2020 dhe faturën nr.127 të datës 31.01.2020 në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi, nëse të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e LPP-së. Kjo pasi që në rastin konkret kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, të cilat fatura në rastin konkret nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 3 të LPP-së. Andaj, në këtë drejtim kjo gjykatë nuk e përkrah qëndrimin e dhomës së shkallës së parë në lidhje me përshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, për çka edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, është paraparë se: “1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. *faturat*”, ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen është përcaktuar shprehimisht se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshmtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Me nenin 37 të LPP-së, është paraparë se: “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”. Kurse me nenin 38 të LPP-së, decidivisht përcaktohet se: “*Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit*”.

Së këndejmi, zbatimi i dokumentit të besueshëm të një vendi tjetër nga Republika e Kosovës i nënshtrohet aplikimit të dispozitës së nenit 11 të LPP-së, e cila përcakton se: “*Përmbartimi i dokumentit të huaj përmbartimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbartimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranin dhe përmbartim*”. Në rastin konkret, shihet qartë se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit mbështetet në fatura të lëshuara nga subjekti juridik i shtetit të huaj, që nënkupton se detyrimi i referohet legjislacionit të vendit të huaj.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i dhomës së shkallës së parë duhet prishur dhe çështja t’i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, ashtu që edhe njëherë të vlerësoj nëse dokumenti përmbartues – faturat i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e konkretisht nëse në rastin konkret faturat e huaja si të tilla a mund ti nënshtrohen përmbartimit konform dispozitave të LPP-së.

Në ri procedurë, dhoma e shkallës së parë duhet të ketë parasysht vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj në mënyrë meritore shkaqet e paraqitura në prapësim, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Kompetenca e Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.727/2023 me datë 30.01.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha